



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:281440

Datë: 22.11.2022

Numri i dokumentit: 03672019

P.nr.148/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me zyrtaren ligjore, Atdhetare Bashota Krasniqi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: N.A, për shkak të veprës penale: Vjedhja e rëndë, nga neni 315, par.1, nënpar.1.1, të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.135/2020 (2020:0004503), të datës 03.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datë 21.11.2022, në praninë e Prokurores së Shtetit Ajtene Zoni dhe të akuzuarit N.A, të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa me datë 22.11.2022, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N.A, nga i ati N..., e ëma Sh..., e vajzërisë A..., lindur me data e lindjes, në ..., Mitrovicë, ndërsa tani banon në ..., Mitrovicë, i papunë, i martuar, baba 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, me numwr tw letwrnjoftimit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Më datën 02.12.2019, rreth orës 04:22, në ..., me qëllim që vetës t'i siguroj dobi të kundërligjshme pasurore, ka marrë gjësendet e luajtshme të huaja-të hollat, ashtu që me përdorim të forcës, me mjet të përshtatshëm ka hapur derën e bastorës "M...", ka hyrë brenda lokalit, ka bërë rrëmujë dhe prej lokalit ka marrë 40500 dinar, në bankënota të ndryshme prej 500 dhe 1000 dinarëve, pastaj është larguar nga vendi i ngjarjes, ku gjatë arratisjes është rrëzuar në shkallë dhe ka pësuar lëndime të lehta trupore, kur edhe është lokalizuar dhe identifikuar nga ana e zyrtarëve policor.

Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhja e rëndë, nga neni 315, par.1, nënpar.1.1, të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69 e 315 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450 dhe 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Dënim me gjobë në shumën prej 200 € (dyqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajnë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43, të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t`ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Obligohet i akuzuari që t`i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.135/2020 (2020:0004503), të datës 03.03.2022, kundër të akuzuarit N.A, për shkak të veprës penale: Vjedhja e rëndë, nga neni 315, par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor ashtu që në këtë seancë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e pranoi fajësinë për këtë veprë penale në tërësi, këtë pranim e bëj në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës. Ndërsa, në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë pranimin të fajësisë, duke i propozuar gjykatës që të shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjendet në shkresat e lëndës, prandaj i propozoj Gjykatës që ta pranoi pranimin e fajësisë. Ndërsa, në fjalën përfundimtare mbeti në tërësi pranë aktakuzës, duke i propozuar gjykatës që ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke i aplikuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 248, të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të akuzuarin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Lista e gjërave të konfiskuara, datë 27.12.2019; Procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit, datë 11.12.2019; Procesverbal mbi marrjen në pyetje për të dëmtuari, datë 02.12.2019; Raport policor, datë 02.12.2019; Lista e gjërave të konfiskuara, data 02.12.2019; Përmbajtja nga raporti i forenzikës dhe raporti nga këqyrja e vendit të ngjarjes, datë 02.12.2019; Fotoalbumi me gjithsejtë 15 fotografi. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin e fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale: Vjedhja e rëndë, nga neni 315, par.1, nënpar.1.1 të KPRK, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej 3 (tre) deri në 7 (shtatë) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69, të KPRK-së. Si rrethana rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale, ashtu që kjo veprë është kryer gjatë natës, pra duke e shfrytëzuar kohën kur askush nuk ka qenë aty, shkallën e përgjegjësisë penale, që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë veprë penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, veprën penale e kishte kryer me dashje direkte dhe me qëllim të përfitimit material për veten e tij.

Ndërsa, si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, moshën e tij, keqardhjen e tij, rrethanat personale dhe gjendjen ekonomike.

Gjykata, në kuptim të nenit 71, par. 1, nënpar.1.3, të KPRK-së, sa i përket dënimit me burgim, në rastin konkret ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë veprë. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 72 par. 1, nënpar. 1.3 të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është 3 vjet, dënimi mund të zbutet deri në 1 vit, çka në rastin konkret Gjykata ka shqiptuar dënim me 1 vit burg.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, i paraparë sipas nenit 38 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i akuzuari t'i përmbahet nga kryerja e veprave penale të kësaj natyre si dhe vepra penale të natyrave të tjera.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2, pika 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesë pasurore juridike, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 463 të KPPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 148/2022, datë 22.11.2022
2021:281440, 22.11.2022

Zyrtare Ligjore
Atdhetare Bashota Krasniqi

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjyaktës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.